



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ROMINA SH. MELI
ADRESA Nj.nr. 9, Rr. Haxhi Hysen
Dalliu, Pallati Përballë Prokurorisë së
Rrethit Tiranë
TEL: 698609109



KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 580

Nr. koleksioni: 150

Tirane më 28/01/2025

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



A2025052570014470146



A2025052570014470146

KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI SHOQËRIA "ROVIGO SOLUTIONS"

Sot, më datë 28 /01/2025 (dy mijë e njëzet e pesë) para meje Notere ROMINA SH. MELI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tiranë, Nj.nr. 9, Rr. Haxhi Hysen Dalliu, Pallati Përballë Prokurorisë së Rrethit Tiranë, u paraqitën personalisht:

DHURUES:

Dorian Mitre, atësia Vasil, amësia Alma, shtetas Shqiptar, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, me adresë Pjetër Bogdani; Nd. 17; H. 2; Ap. 19; Njësia Administrative Nr. 5; 1019; lindur më 22/07/1989, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033821354 dhe nr. personal I90722065A ortak i **Shoqëria ROVIGO SOLUTIONS**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M32219017A, datë 19/10/2023 me adresë Njesi Administrative Nr.9, Rruga 'Haxhi Hysen Dalliu', Nd. Nr. 89, H.20, Ap. 14, 1016 Tirane.

Sildi Mustafa, atësia Shkëlqim, amësia Matilda, shtetas Shqiptar, lindur në Janinë, Greqi (GRC) dhe banues në Tiranë, me adresë Bardhok Biba; Nd. 48; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 08/04/2000, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035592964 dhe nr. personal K00408069P ortak i **Shoqëria ROVIGO SOLUTIONS**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M32219017A, datë 19/10/2023 me adresë Njesi Administrative Nr.9, Rruga 'Haxhi Hysen Dalliu', Nd. Nr. 89, H.20, Ap. 14, 1016 Tirane. (Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Dhuruesi**")

PRANUES I DHURIMIT:

Shkëlqim Mustafa, atësia Mustaf, amësia Mire, shtetas Shqiptar, lindur në Micoj, Pukë dhe banues në Tiranë, me adresë Bardhok Biba; Nd. 48; Njësia Administrative Nr. 9; 1016; lindur më 02/04/1971, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033094197 dhe nr. personal H10402036H ortak i **Shoqëria ROVIGO SOLUTIONS**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M32219017A, datë 19/10/2023 me adresë Njesi Administrative Nr.9, Rruga 'Haxhi Hysen Dalliu', Nd. Nr. 89, H.20, Ap. 14, 1016 Tirane. (Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Përfituesi i dhurimit**")

Rrethanat e hartimit të aktit:

Personat e lartpërmendur me vullnetin e tyre të lirë, të plotë hartuan kete kontrate për dhurimin e kuotave të kapitalit. duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

Kushte paraprake:

Pala Dhuruese **Dorian Mitre**, është pronar dhe ortak me 40% (dyzet përqind) të kuotavë të kapitalit të shoqërisë "**ROVIGO SOLUTIONS**" Sh.p.k me NIPT : M32219017A .

Pala Dhuruese **Sildi Mustafa**, është pronar dhe ortak me 40% (dyzet përqind) të kuotave të kapitalit të shoqërisë "**ROVIGO SOLUTIONS**" Sh.p.k me NIPT : M32219017A

Ortaku i shoqërisë **Dorian Mitre** ka vendosur të kryejë dhurimin e kuotave të kapitalit që zotëron në masën 40% (dyzet përqind) duke hequr dorë nga e drejta e pronësisë në mënyrë të plotë konform



ligjit sipas kushteve që do të citohen më poshtë për t'ia dhuruar këto të drejta duke përfshirë dhe detyrimet z. Shkëlqim Mustafa.

Ortaku i shoqërisë **Sildi Mustafa** ka vendosur të kryejë dhurimin e kuotave të kapitalit që zotëron në masën 20% (njëzet përqind) duke hequr dorë nga e drejta e pronësisë në mënyrë të plotë konform ligjit sipas kushteve që do të citohen më poshtë për t'ia dhuruar këto të drejta duke përfshirë dhe detyrimet z. Shkëlqim Mustafa.

z. Shkëlqim Mustafa deklararon se pranon dhurimin e kuotave të kapitalit të ortakut të shoqërisë "**ROVIGO SOLUTIONS**" Sh.p.k në masën 60% (gjashtëdhjetë përqind) duke u shndëruar në bashkë/ortak me nga një kuotë të barabartë në masën 70% të shoqërisë "**ROVIGO SOLUTIONS**" Sh.p.k me ë gjitha të drejtat dhe detyrimet si bashkë/ortak të shoqërisë me kushtet si do të caktohen më poshtë:

Baza Ligjore

1. Neni 761 e vijues të Kodit Civil
1. Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", i ndryshuar
- Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "*Për Noterinë*"

Neni 1 OBJEKTI: Dhurimi i kuotave të shoqërisë "**Shoqëria ROVIGO SOLUTIONS**" në masën 60% të kapitalit themeltar, kuota këto që zotërohen nga ortakët e shoqërisë **z.Dorian Mitre dhe Sildi Mustafa** në cilësinë e Dhuruesit dhe pranimi i dhurimit të tyre nga **z.Shkëlqim Mustafa** në masën 60% me cilësinë e Pranuesit të Dhurimit.

Neni 2 PËRMBAJTA E KONTRATËS:

Shoqëria Tregtare "**Shoqëria ROVIGO SOLUTIONS**" është regjistruar me datë 19/10/2023 pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NIPT M32219017A. Shoqëria ka një kapital themeltar të regjistruar prej 609.950,00 (gjashtëqind e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lekë si më poshtë vijon:

2. **Dorian Mitre** zotëron 40 % të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë "**ROVIGO SOLUTIONS**" Sh.p.k.
3. **Sildi Mustafa** zotëron 40 % të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë "**ROVIGO SOLUTIONS**" Sh.p.k.

Me vendimin e datës 23/01/2025 të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë është vendosur dhurimi i kuotave në masën 60% të tyre nga ana e ortakëve të shoqërisë.

Dorian Mitre në masën 40% dhe **Sildi Mustafa** në masën 20% dhe pranimi nga ana e **Shkëlqim Mustafa** në masën 60%.

Dhuruesi **Dorian Mitre dhe Sildi Mustafa** janë plotësisht dakord të dhurojnë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë në masën prej 40% dhe 20% të kuotave që ata zotërojnë në shoqërinë "**Shoqëria ROVIGO SOLUTIONS**" Sh.p.k.



A2025052570014470146

Ky dhurim kuotash, sipas kësaj kontrate do të bëhet në favor të pranuesit të dhurimit **Shkëlqim Mustafa**, i cili përfiton zotërimin e 60% të kuotave.
Pranuesi i dhurimit **Shkëlqim Mustafa**, është plotësisht dakord që të pranojë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, masën prej 60% të kuotave të zotëruara nga dhuruesit në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare "**Shoqëria ROVIGO SOLUTIONS**" Sh.p.k.

Neni 3 MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhuruese, ortakët e shoqërisë **Dorian Mitre** humbet pronësinë përkatësisht në masën 40%, të kuotave të zotëruara prej tij në kapitalin themeltar të shoqërisë "**ROVIGO SOLUTIONS**" Sh.p.k, duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi keto kuota të shoqërisë dhe

Ortaku Sildi Mustafa humbet pronësinë përkatësisht në masën 20%, të kuotave të zotëruara prej tij në kapitalin themeltar të shoqërisë "**ROVIGO SOLUTIONS**" Sh.p.k, duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi keto kuota të shoqërisë.

Ndërsa pranuesi i dhurimit **Shkëlqim Mustafa** bëhet pronar përkatësisht në masën prej 70% të kuotave të dhuruara, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart dhurimi i këtyre kuotave.

Neni 4

Shoqëria Tregtare "**ROVIGO SOLUTIONS**" Sh.p.k, pas realizimit të kësaj kontrate dhurim kuotash, do të ketë si ortakë të saj me pjesëmarrje në kapitalin themeltar si më poshtë:

- **Shkëlqim Mustafa** zotëron **70%** të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë "**ROVIGO SOLUTIONS**" të cilat përfaqësojnë 1 (një) Kuotë të kapitalit të shoqërisë.
- **Sildi Mustafa** zotëron **20%** të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë "**ROVIGO SOLUTIONS**" të cilat përfaqësojnë 1 (një) Kuotë të kapitalit të shoqërisë.
- **FENZI INVESTMENTS AND ASSET MANAGEMENT LTD** zotëron **10%** të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë "**ROVIGO SOLUTIONS**" të cilat përfaqësojnë 1 (një) Kuotë të kapitalit të shoqërisë.

Administrator i shoqërisë do të ngelet z. **Sildi Mustafa**.

Neni 5 Heqje dorë nga të drejtat

Pala dhuruese **Dorian Mitre** dhe **Sildi Mustaf** deklarohen nën përgjegjësinë personale, se heq dorë nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i takojnë në cilësinë e pronarit/ortakut në lidhje me shoqërinë "**ROVIGO SOLUTIONS**" Sh.p.k menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 6 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo lloj mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me interpretimin osë zbatimin e kësaj kontrate, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve, në rast të kundërt komptente për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykta e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Bashkëlidhur gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:
ekstrakt i shoqërisë "**ROVIGO SOLUTIONS**" Sh.p.k
Regjistri i barrëve siguruese.

id e palëve.



A2025052570014470146

Palët bien dakord që depozitimi i aplikimit përkatës për regjistrimin e kalimit të pronësisë në regjistrin tregëtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit, do të kryhet brënda 30 ditëve pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata e Dhurimit të Kuotave, u lexua me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë të cilët e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht.

DHURUESI

Dorian Mitre

Sildi Mustafa

PALËT

PRANUESI I DHURIMIT

Shkëlqim Mustafa

NOTERE

ROMINA SH. MELI